


# TI E BËN NDRYSHIMIN



# DEMOKRACIA SI FORMË E QEVERISJES

DRINOR (14), ALTIN (15), RITA (14), DAFINA (14), ELDI (14), NOLI (14), ERZA (14), RONI (14)



## Çfarë dijmë ne për demokracinë?

Demokracia është formë e qeverisjes në Kosovë. Ajo u krijua qysh në kohët e hershme, në vitin 507 p.e.s. në Athinë (Greqi). Përmes demokracisë, populli mund të shprehë pakënaqësitë e veta. Kjo formë e qeverisjes praktikohet edhe në ditët e sotme.

Demokracia është sistem i modernizuar, në të cilin përfshihen elementet dhe institucione të ndryshme qeverisëse si: Kuvendi, Qeveria, Kushtetuta, etj. Demokracia ndahet në demokraci përfaqësuese dhe atë të drejtëpërdrejtë. Ajo përfaqësuese zbatohet duke zgjedhur përfaqësuesit nga populli, ndërsa ajo e drejtëpërdrejtë lejon popullin të udhëheqë vetë shtetin.

Në demokraci mund të ketë pakënaqësi, të cilat shfaqen përmes protestave, peticioneve, etj. Me vullnet dhe

bashkëpunim edhe këto vështirësi mund të tejkalohen. Gjithashtu, sot mësuam se në demokraci edhe në mund të bëjmë një ndryshim të madh dhe se mendimi ynë ka vlerë, sepse ne kemi të drejta dhe respektohemi në demokraci.



Edhe fëmijët mund të punojnë për zhvillimin e demokracisë

# KUVENDI I KOSOVËS

DIELLZA (14), ELENA (14), TRINGA (14), EUROLIND (14), ENIS (14), ANYLA (13), GENTRIT (14)



## Funksionet kryesore të Kuvendit

Kuvendi është organ ligjvënës, sepse në të nxirren dhe miratohen ligjet. Ligjet miratohen nga deputetët, të cilët zgjedhen nga populli përmes votave të tyre. Në mënyrë që qytetarët të votojnë, ata duhen të jenë mbi moshën 18 vjeçare. Ato votohen nga pozita dhe opozita. Pozitë janë ata deputetë, të cilët kanë marrë më së shumti vota gjatë zgjedhjeve, kurse opozita janë ata që kanë marrë më pak vota sesa pozita. Koncepti bazë i Kuvendit është drejtësia, sepse ai i trajton të gjithë njësoj, pa dallim race, gjinie, besimi dhe moshe. Deputetët e Kuvendit duhen të jenë: mendjhapur, tolerantë, demokratë, neutral dhe të pa korruptueshëm. Mandati i një deputeti është 4 vjet, kurse mandati i Presidentit është 5 vjet.

Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë, ku 20 vende i takojnë komuniteteve jo shumicë. Në krye të Kuvendit është Kryetari i Kuvendit, i cili ka për detyrë të hartojë planin ditor dhe të udhëheq Kuvendin. Gjithashtu, në Kuvend kryhet edhe votimi për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Takimet e Kuvendit quhen seanca plenare. Ato janë takime ku diskutohen dhe votohen ligjet e propozuara, që quhen projektligje. Projektligjet propozohen nga Qeveria, Presidenti, deputetët dhe nga më së paku 10.000 qytetarë. Në Kuvend ka disa komisione, disa prej tyre janë Komisioni i Shëndetësisë, Komisioni i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Komisioni i Bu-

jqësisë, etj.

Kuvendi është shtëpia jonë, sepse aty merren vendime të rëndësishme për jetën tonë. Ne si nxënës mësuam sot që ligjet që ndikojnë më së shumti në jetën tonë janë ligjet për arsim, shkencë dhe teknologji, ligjet për komunikacion dhe ligjet për shëndetësi. Prandaj, vota jonë ka rëndësi për të ardhmen e shtetit tonë, kështu që ne duhet të kemi kujdes se për kë do të votojmë.



# TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E QYTETARËVE

ORHIDEA (14), VIGAN (14), FJOLLA (14), REDON (14), LAURA (15), ENDI (15), DENIRA (15)



## Çdo të thotë të jesh një qytetar?

Ne si qytetarë kemi mjaft shumë detyra dhe përgjegjësi që të kemi një shtet sa më të mirë dhe më të zhvilluar. Pastërtia e ambientit, respektimi i ligjeve, solidarizimi dhe shumë detyra të tjera duhet zbatuar në mënyrë që të jemi qytetarë sa më të denjë për shtetin tonë. Shkollimi i pandërprerë i fëmijëve është po ashtu i domosdoshëm, sepse në Kosovë ka mjaft fëmijë dhe të rinjë që janë shumë të mençur dhe të cilët u nevojiten shtetit tonë. Shteti ynë ka shumë bukuri natyrore, të cilat ne duhet t'i ruajmë, të kujdesemi për to dhe t'i pastrojmë vazhdimisht, sepse për to ne gjithmonë do të kemi nevojë.

Një kriter tjetër për një qytetar ideal është edhe solidarizimi ndaj të tjerëve. Një ndër mënyrat si mund të arrijmë këtë është edhe dhurimi i gjaku, ku këtu në Kosovë është i njohur Kryqi i Kuq që çdo vit organizon shumë dhurime gjaku për njerëzit në nevojë. Shumë njerëz bamirës në Kosovë u dalim në ndihmë njerëzve në nevojë edhe me anë të ndihmave financiare.

Qytetarë të denjë për shtetin tonë, jemi atëherë kur respektojmë njëri-tjetrin, kur mbajmë pastër ambientin, kur kujdesemi për njëri-tjetrin dhe kur solidarizohemi me të gjithë. Ne sot kuptuam se për të qenë qytetarë i denjë për popullin tonë duhet t'i respektojmë ligjet dhe njëri-tjetrin pa marrë parasysh fenë, racën dhe gjininë.



Duke vizatuar një shkollë të pastër



Fëmijët të cilët punuan artikullin

## NJË VOTË PËR TË ARDHMEN

RINA (14), LEKË (14), ALTIN (14), ALTINA (15), RINESA (14), VLERA (14), JORA (14)



### Grupi ynë do t'iu njoftojë më shumë rreth zgjedhjeve dhe për rëndësinë e tyre rreth formimit të demokracisë

Po të jetonim në një botë para ca shekujve, do të vërejm ndryshime të mëdha nga ajo që e jetojmë sot.

Shteti atëherë kishte formën e një popullate të përbërë nga klasa të shumta, ku vetëm ata me një pjesë të madhe pasurie kishin të drejtën e votës. Mirëpo, ndonjëherë as kjo nuk ishte e mundur. Pas shekullit XVII mënyra e votimit filloi të ndryshojë. Para kësaj periudhe, të drejtë vote kishin vetëm meshkujt. Por, plotësimi i mëtejshëm i demokracisë filloi me përfshirjen e femrave në procesin zgjedhor.

Sot, ky proces ka disa parakushte: e drejta për të votuar në procesin e zgjedhjeve iu takon vetëm personave mbi moshën 18 vjeçare. Megjithatë, këtë të drejtë e gëzojnë të gjithë qytetarët pa dallime fetare, racore apo gjinore.

Zgjedhjet ndahen në dy lloje: zgjedhjet lokale (kryesia e një komune) dhe zgjedhjet qendrore (zgjedhja e përfaqësuesve në Kuvend). Zgjedhjet e rregullta në Kosovë mbahen çdo katër vjet. Votimi na ka ndihmuar si popull të arrijmë në pikën ku ndodhemi. Me anë të votës, sot ka drejtësi brenda shtetit tonë.

Ne sot kemi mësuar se pse vota është shumë e rëndësishme. Gjithashtu, mësuam se çdo votë ka vlerën e saj dhe se askush nuk duhet të ndikojë në mendimin tonë për zgjedhjen e votës. Po ashtu, zgjedhjet janë

element thelbësor i demokracisë.

Mendimi yt dhe vota jote mund të ndryshojë të ardhmen. Kur të mbushim 18 vjet do të jemi të pavarur dhe do të kemi të drejtë të marrim pjesë në zgjedhje dhe të votojmë kandidatët, të cilët do të punojnë për të siguruar mirëqenien e popullit.



**Një votë të mirë për një të ardhme më të mirë!**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë